




Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zastitu
Department of Health and Social Welfare

Datë/Datum/Date:	21.07.2020
Referenc-ë	
CC	
Për/Za/To:	Sekretarin e Kuvendit- Rahovec
Nga/Od/From:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec
Subjekti/Predmet/Subject:	Informal për planin 6 mujorë DSHPS



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë kësaj periudhe raportuese 6 mujore ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2020. Ky raport përfshin në mënyrë gjithëpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e Kujdesit Parësor Shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

Aktivitetet në periudhën: janar, Qershor 2020

DSHPS qysh në fillim të vitit 2020 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësisë të përshkruara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit - shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore me dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, poashtu, në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat e tjera të komunës sonë.

Nga muaji marrs, është karakterizuar me një sërë aktivitete dhe masa të ndërrmarra nga Komuna e Rahovecit, për covid-19 si drejtori në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të situatës nga përhapja e Covid-19, kemi ngritur në nivel të lartë gadishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërrmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga Virusi Korona COVID-19 si drejtori e shëndetësisë i kemi zbatuar të gjitha rekomadimet e dala nga IKSHP-ja, ku edhe gjatë inspektimit nga ministria e shëndetësisë, përkatsisht inpektorët shëndetësor QKMF-ja, osht vlersuar maksimalisht që i zbaton rekomandimet të IKPSH-së.

Deri në këto momente kur po raportojmë kemi gjithsej 100 raste me covid-19, raste active jane 28, te shëruar jane 60, dhe me fatalitet janë 12 raste, po ashtu edhe deri në këto momente kur po raportojmë 6 pacient janë të shtrirë në klinikën infektive, ku dy janë në gjendje të rend.

Në mënyrë që të ofrojmë shërbime profesionale dhe të sigurta për qytetarët, tashmë kemi marrë vendim që në të dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, edhe ditën e shtunë të punohet me orar të rregullt.

Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal, është miratuar propozim-vendimi i Kryetarit, z.Smajl Latifi për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000 euro, për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Më anë të këtij vendimi kemi vënë në dispozicion 10.000 (dhjetëmijë) euro, mjete këto që do të shfrytëzohen për mbulimin e kërkesave dhe nevojave të Shtabit të Posaçëm Emergjent, më saktësisht për menaxhimin e situatës së krijuar nga ky virus, duke përfshirë këtu furnizimin me barna ose përkrahjen për rastet sociale.

Kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit, si: objektet shëndetësore (QKMF, QMF-të, AMF-të), objektet e Administratës Komunale, objektet fetare: (Xhamitë dhe Teqetë), Stacioni i Autobusëve, Stacioni Policor, objekte kulturore dhe sportive etj. Vlen të theksohet se objektet shëndetësore dezinfektohen çdo vikend, ndërsa repartit i mjekësisë familjare dhe kujdestaria dezinfektohen dy herë në javë për shkak se janë reparte më të frekuentuara nga qytetarët tanë.

Objektet shëndetësore dezinfektohen qdo javë, ndërsa QKMF-ja, dhe kujdestari dezinfektohen dy (2) herë në javë, deri më tani objektet shëndetësore janë dezinfektuar 20 herë.

LISTA E OBJEKTEVE TË DEZINFEKTUARA NË KOMUNËN E RAHOVECIT

QKMF, QMF-të, AMF-të	20 - objekte shëndetësore	Komuna Rahovec
Objekte fetare	24 -xhami në tërë Komunën e Rahovecit	Komuna Rahovec
Objekte fetare	2 -teqet në Rahovec	Komuna Rahovec
Objekte kulturore dhe sportive	Palestra Sportive, shtëpitë e kulturës	Komuna Rahovec
Objekti i pasaportave	1 – Kompetencë e MPB	Komuna Rahovec
Stacioni i autobusëve	5-Stacioni i autobusëve në Rahovec	Komuna Rahovec
Stacionet Policore	2- Stacioni policor në Rahovec dhe nënstacioni Policor në Zoqisht	Komuna Rahovec
Objektet e Komunës së Rahovecit	10- Objektet e Administratës Komunale në Rahovec, të dezinfektuara në tërësi	Komuna Rahovec
Institucione të drejtësisë	2 Objekti i Gjykatës Themelore Gjakovë- dega në Rahovec	Komuna Rahovec
Institucione arsimore	2 Çerdhja "Tulipanët" në Rahovec	Komuna Rahovec
Sektori privat	3 Kompanitë private që kanë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve	Komuna Rahovec

Komuna e Rahovecit, përkatësisht DSHPS-ja, ka planin operativ duke caktuar edhe vendin për ngritjen e një karantine e cila në rast nevojë, do të përdoret me qëllim të menaxhimit të rasteve të ekspozuara ndaj virusit, sipas nevojës, ky plan zbatohet në rast përqendrimit të gjendjes me covid-19. Pas situatës së krijuar

nga rreziku i infeksionit COVID-19, të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, individë e biznese, po vazhdojnë, traditën, humanizmin dhe solidaritetin, në mbështetje të qytetarëve, duke dhuruar kështu donacione të ndryshme si: pako ushqimore dhe higjienike, destilat, dezinfektues për duar, ndihmë në vlerë monetare etj.

Shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike është bërë në përputhje me listat e përpiluara në bashkëpunim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit, Qendrën për Punë Sociale në Rahovec dhe Kryqin e Kuq.

Si drejtori vazhdimisht jemi ballafaquar me mungesë të materialit mbrojtës për personelin mjekësor si maskat mbrojtëse, dorëzat, dezinfektues, rroba mbrojtëse dhe syza mbrojtëse për personelin shëndetësor që janë vija e parë e frontit me COVID-19.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Ndërtimi i QKMF-së, faza e dytë dhe përfundimtare, projekti deri më tani ka arritur në 85%, besojmë se deri në fund të muajin korrik, shpejtë do të përfundojmë objektin e QKMF-së dhe Emergjencës;
- Në Çifllak po vazhdojnë punimet për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare! Ky projekt kap vlerën prej 82,996 eurove, punimet pritet të përfundojnë në muajin Korrik të vitit 2020 një objekt modern që doti plotësoj nevojat e qytetarëve duke iu ofruar shërbime sa më cilësore.
- Në muajin korrik fillon ndërtimi I objektit të ri të QMF-së, në fshatin Apterush.

Mirëqenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj, poashtu, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare. Pra, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia.

Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
QENDRA PËR PUNË SOCIALE

GJENDJA E PANDEMISË COVID-19

Aktivitetet e QPS-së në Rahovec, nga 16 marsi 2020 për shkak të masave mbrojtëse kundër sëmundjes COVID-19, kanë marrë trajtë tjetër të veprimeve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe të ndihmës sociale familjeve në nevojë.

Qendra për Punë Sociale në zbatim të vendimeve për parandalimin pandemisë COVID - 19 ka vepruar në përputhje me situatën e krijuar duke zbatuar vendimet e qeverisë qendrore dhe të Komunës së Rahovecit.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale në kohën e pandemisë, QPS ka pranuar dhe zbatuar këto vendime:

1. REDUKTIMI I STAFIT NË STAF TË DOMOSDOSHËM DHE REDUKTIMI I OFRIMIT I SHËRBIMEVE SOCIALE NË TË DOMOSDOSHME

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/07 të dt.11.03.2020, janë përcaktuar masat fillestare, ndërsa pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19, Qeveria ka nxjerrë vendimin Nr.01/09 të datës 13.03.2020 ku në pikën 9 janë paraparë masat për ofrimin e shërbimeve esenciale nëpër institucione publike dhe private.

QPS më 16 mars ka reduktuar stafin duke caktuar staf të domosdoshëm (esencial) dhe duke punuar në grupe të vogla 3-4 zyrtarë, me ndërrime, për të ofruar vetëm shërbime emergjente, (shembull: dhuna në familje), si dhe shërbime tjera të domosdoshme, (shpërndarja e pakove ushqimore). Drejtori i QPS-së me parashtrësë të veçantë ka caktuar stafin esencial në grupe të vogla me ndërrime për parandalimin e infeksionit COVID-19.

Me kërkesën e DPSF-së, më 25 prill 2020, janë angazhuar personeli shtesë për të zbatuar masën Nr.15, duke angazhuar edhe stafin e shërbimeve sociale për të përballuar fluksin e aplikacioneve për pakon emergjente fiskale të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

2. MASA NR.15 E PAKOS EMERGJENTE FISKALE

Vendimin Nr.35/2020 të dt. 16.04.2020 të Ministrisë së Financave dhe Transfereve me të cilin është obliguar Divizioni i Ndhimave Sociale të bashkëpunojë dhe të ofrojë mbështetje Qendrave për Punë Sociale për zbatimin e Masës Nr.15 të Pakos Emergjente Fiskale. Me këtë rast drejtori i QPS-së fillimisht ka caktuar dy zyrtarë nga Shërbimi i Skemës së Ndhmës Sociale të cilët ndër të tjerë do të pranojnë dhe përpunojnë aplikacionet për familjet që janë të papunë dhe pa të ardhura financiare. Ministria e Financave dhe Transfereve me këtë qëllim ka lëshuar një letërqarkore zbatimin e Masës Nr.15, të datës 17.04.2020.

Për Masën Nr.15, deri më 15 maj 2020, kanë aplikuar gjithsej 1891 familje të Komunës së Rahovecit. Sipas vendimit të lartcekur Divizioni i Ndhimave Sociale vendos listën e përfituesve të pakos dhe të njëjtën listë ia dërgon Thesarit për ekzekutim.

Qendra për Punë Sociale është ballafaquar me shumë probleme në zbatim të Masës Nr.15 për faktin se kanë aplikuar një numër i madh i familjeve, ndërsa prej tyre që u është njohur e drejta për këtë masë janë vetëm një numër i vogël i përfituesve.

Me kërkesën e DPSF-së, më 25 prill 2020, janë angazhuar personeli shtesë për të zbatuar masën Nr.15, duke angazhuar edhe stafin e shërbimeve sociale për të përballuar fluksin e aplikacioneve për pakon emergjente fiskale të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

3. KARANTINIMI I VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

QPS ka zbatuar në tërësi Qarkoren Nr.09/2020 e Ministrisë së Shëndetësisë e datës 27.04.2020 për karantinimin e viktimave të dhunës në familje. Ky karantinim ka funksionuar deri më 30 maj 2020. Qendra për Punë Sociale ka pasur dy raste të dhunës në familje të karantinuara në Qendrën e Studentëve në Prishtinë. Këto dy raste janë transportuar me veturat e QKMF-së nga Rahoveci dhe nën përcjelljen e policisë së bashku me dy zyrtarë të QPS-së dhe janë karantinuara për kohën e caktuar në këtë qendër. Lidhur me këto raste QPS ka zbatuar në tërësi Procedurën Standarde të Operimit (PSO) për Trajtimin dhe Kujdesin për Viktimat e Dhunës në Familje të Vendosur në Karantinë, të MSH-së.

Përveç rastet e dhunës në familje, janë trajtuar edhe rastet emergjente, siç janë trajtimi i personave me retardime mendore ku është ofruar shërbimi i nevojshëm sipas procedurave në bashkëpunim me QKMF-në dhe Policinë e Kosovës.

Gjatë kohës në pandemi, e cila vazhdon deri në ditën përpilimit të këtij raporti, QPS ka mbajtur kujdestari të rregullt ku janë angazhuar stafi profesional të cilët kanë ndërmarrë veprime të nevojshme varësisht nga rasti që është referuar. Deri më tani kemi pasur 15 raste të ndryshme që janë referuar jashtë orarit të punës e të cilët raste janë trajtuar sipas standardeve të përcaktuara për ofrimin e shërbimeve sociale.

4. SUSPENDIMI I PËRKOJSHËM I PROCEDURAVE PËR NDIHMË SOCIALE

Sipas Vendimit Nr.283-1 të dt.07.04.2020 të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, në afat të pacaktuar janë pezulluar procedurat e riaplikimit për familjet në Skemën e Ndihmës Sociale, siç janë: Ripërtëritja e dokumenteve, vlerësimet nga Komisionet Mjekësore, verifikimi i gjendjes sociale-ekonomike në terren, me kusht që pas kalimit të gjendjes së pandemisë COVID - 19 të kompletohen të gjitha dosjet me dokumentacion të kërkuar sipas ligjit të SNS-së.

Për muajin prill, maj dhe qershor, janë obliguar udhëheqësit e SNS-së nëpër QPS që të ndërmarrin veprimet gjatë pandemisë në mënyrë që: Ri aplikimi të behët me dokumentacioni ekzistues të cilin e keni në dosjen e përfituesit, pa prezencën e palës; Vlerësimet komisioneve mjekësore, të vazhdohet me Certifikata të njëjta ekzistues të cilat kanë qenë të aprovuar për periudhën paraprake nga Komisionet mjekësore; Vërtetimet nga Zyrat e Punësimit, të përdoren ato nga tremujorëshi i fundit; Verifikimi i familjeve në teren (Formulari A3) të rishkruhet nga verifikimi i mëparshëm; Pas këtyre veprimeve obligohen të nxjerrin Vendimet për njohjen e së drejtës në ndihmë sociale për familjet e ri aplikuar në muajin qershor 2020.

Të gjitha këto duke shtuar kujdes të veçantë që gjatë procedurës së ri aplikimit mund të këtë familje e cila nuk duhet të ri aplikohet, dhe lidhur me këtë pas kalimit të gjendjes emergjente pason auditimi.

Gjithashtu Vendimi Nr. 40, dt. 23.04.2020, për Pezullimin e kriterit të moshës së fëmijës nën 5 vjeç duhet janë zbatuar edhe për muajin qershor 2020. Ndërsa, duke filluar nga muaji korrik 2020, Vendimi Nr. 40, dt. 23.04.2020, për Pezullimin e kriterit të moshës së fëmijës nën 5 vjeç për kategorinë e dytë në ndihmë sociale ka skaduar, andaj lidhur me këtë, gjatë riaplikimit në muajin korrik 2020 duhet të veprohet sipas ligjit në fuqi.

5. SHPËRNDARJA E PAKOVE USHQIMORE PËR FAMILJET NË NEVOJË SOCIALE

Kryetari i Komunës së Rahovecit me vendim Nr.390 të datës 14.03.2020 ka themeluar Shtabin e Posaçëm Emergjent për parandalimin e infeksionit COVID - 19. Ndërsa, me vendim Nr.373 të datës 30.03.2020 ka caktuar komisionin për shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë në Komunën e Rahovecit. Me vendimin për shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë, QPS-së i janë dhënë detyrat e vlerësimit dhe organizimit të shpërndarjes së pakove ushqimore për familjet në nevojë emergjente. Ky komision ka bashkëpunuar me këshillat e fshatrave dhe të lagjeve urbane për të shpërndarë pakot ushqimore si dhe me Kryqin e Kuq të Kosovës – dega në Rahovec.

Janë shpërndarë 750 pako ushqimore me miell nëpër të gjitha fshatrat për familjet në asistencë sociale si dhe familjet tjera në nevojë, ndërsa në qytet janë shpërndarë 795 pako ushqimore me miell, 73 familje Romë, Ashkali dhe Egjiptas nga dy herë pako ushqimore me miell si dhe 50 familje serbe në lagjen e epërme.

Deri më 23.05.2020 ky komision ka shpërndarë gjithsej 1740 pako ushqimore dhe 1800 thasë miell për familjet që janë vlerësuar se kanë nevojë për ndihmë me ushqim për shkak të gjendjes së kufizimit të lëvizjes dhe gjendjes në kohën e pandemisë. Komisioni, në mbështetje nga stafi teknik i Komunës së Rahovecit dhe stafi i QPS-së, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës dega në Rahovec, kanë shpërndarë pakot ushqimore 7 ditë në javë për të arritur qëllimit për t'u dalur në ndihmë familjeve në nevojë sociale, familjeve me persona me aftësi të kufizuar, veteranëve, familjeve të dëshmorëve, etj.

Krushë e Madhe	58	Opterushë	15	Ratkoc	59	Çifllak	31	Drenoc	25	Xërxë	61	Rahovec	795
Celinë	37	Reti+Reti Ulët	23	Gegje	9	Kramovik	23	Pastasel	35	Bellacerk	15	Lagja 1	0
Nagavc	13	Zoqishtë	14	Radoste	29	Polluzhë	6	Senoc	25	Pataqan i Ulët	22	Lagja 2	0
Brestoc	22	Hoçë e Madhe	25	Vranjak	30	Guri i Kuq	31	Koznik	6	Pataqan i Epërm	9	Lagja 3	0
Hoçë e Vogël	11			Dabidol	22	Mrasor	0	Zatriq	8	Sapniq	21	Lagja 4	0
				Bratotin	11					Nashpall	9	Lagja 5	0
				Dejnë	44							Lagja RAE	146
												Lagja Serbe	50
GJITHSEJ:	141		77		204		91		99		137		991

Gjatë shpërndarjes së pakove ushqimore, Kryetarit të Komunës i janë lajmëruar një numër i madh i donatorëve, posaqërisht bashkatdhetarët të cilët jetojnë dhe punojnë në Botën e jashtme, të cilët kanë shprehur vullnetin për të kontribuar për familjet në nevojë sociale.

Disa prej atyre të cilët kanë kontribuar me pako ushqimore dhe miell, janë:

1. VIVA FRESH me 200 Pako ushqimore dhe 200 thasë Miell;
2. ELKOS ka ndihmuar me 200 thasë miell, qumësht dhe lëngje;
3. Sheh Besim Shehu, Teqeja e Madhe, me 100 pako ushqimore;
4. Munib Rrahmani, bashkatdhetar nga Anglia, 100 pako me 100 thasë miell;
5. Behar Hajda, bashkatdhetar nga Zvicra, 100 pako dhe 100 thasë miell;
6. Arben Hajda, bashkatdhetar nga Zvicra, 150 pako dhe 150 thasë miell;
7. OJQ Jetimat e Ballkanit, 100 pako ushqimore;
8. OJQ Labinot Tahiri, 100 pako ushqimore;
9. Afrim Kasapi, bashkatdhetar nga Zvicra 100 pako dhe 100 thasë miell;
10. Beshir Sokoli, bashkatdhetar, 100 pako dhe 100 thasë miell;
11. Arton Morina, 100 thasë miell;
12. AQH Swiss, me 173 pako ushqimore dhe higjienike, etj.

01-Nr. 92/20
Me datë:29.07.2020



Kryesuesi i Kuvendit